



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. prot. 17556

Tiranë, më 3.5. 2024

Lënda: Shpallje për vende të lira pune

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit Nr.243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tiranë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

157- Specialist për Urbanistikën, Sektori i Shërbimeve Publike , Njësia Administrative, Njësia Bashkiake nr. 5 , Bashkia Tiranë - Kategoria: IV-a

Lutemi shpallja bashkëlidhur të publikohet në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Faleminderit për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Enkeleida Omeri

Shpallje pozicioni pune

Procedura

Lëvizja paralele

Procedura

Pranim në shërbimin civil

Kategoria

Kategorinë ekzekutive

Pozicioni

157- Specialist për Urbanistikën, Sektori i Shërbimeve Publike , Njësia Administrative, Njësia Bashkiake nr. 5 , Bashkia Tiranë - Kategoria: IV-a

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tiranë shpall procedurat lëvizja paralele pranim në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

157- Specialist për Urbanistikën, Sektori i Shërbimeve Publike , Njësia Administrative, Njësia Bashkiake nr. 5 , Bashkia Tiranë - Kategoria: IV-a

Kodi i shpalljes

157

Lloji i diplomës

Shkenca Inxhinierike/Urbanistikë/Arkitekturë

Niveli minimal i diplomës

Bachelor

Kategoria e pagës

IV-a

Institucioni

Bashkia Tiranë

Kur bëhet aplikimi ?

Për procedurën (lëvizje paralele, pranim në shërbim civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave

Lëvizja Paralele

12/05/2024

Pranim në shërbimin civil

17/05/2024

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:

- 1- Bashkëpunon me Ndërmarrjet e Punëtoreve, Inspektoriatin e Mjedisit Urban (Bashkia e Tiranës), Agjensinë Rajonale të Mjedisit, për problemet e angazhimit dhe edukimit mjedisor të cilat lidhen me mjedisin
- 2- Bashkëpunon me Zyrat e Gjendjes Civile, për konfirmimin e adresave kodeve të banesave
- 3- Merr masa dhe duhet të përgjigjet për problemet të cilat lidhen me emergjencat civile, në funksion të ligjit; 329, datë 16.5.2012 për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për shpërblimin e dëmit
- 4- Trajton problemet të cilat lidhen me adminstrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, duke bashkërenduar punën me administratorët dhe Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi
- 5- Bashkërendon punën me zyrën e kadastrës për përgatitjen e dokumentave për marrje të pronësisë, si dhe ofron asistencë teknike dhe ligjore për zgjidhje të problematikave që lidhen për pronësinë, në përputhje me kuadrin ligjor respektiv
- 6- Evidenton problemet të cilat konstatohen në terren në lidhje me infrastrukturen mbikësore (pallate, ndërtesa banimi)
- 7- Ndjek problemet të cilat evidentohen nga komuniteti, në lidhje me pastrimin dhe gjelbërimin e ambienteve dhe jep asistencë teknike për qytetarët të cilët paraqiten pranë zyrave të Njesisë Administrative

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1

KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal Bachelor në Shkenca Inxhinierike/Urbanistikë/Arkitekturë.

1.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
https://rekrutimi.tirana.al/CVTemplate_Jeteshkrimi
 - b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
 - c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 - i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen online, në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Bashkisë Tiranë, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijmësi udhëzimet online .
- <https://tirana.al/punesimi/vende-pune>

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës:
12/05/2024

1.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 14/05/2024, Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Tiranë, do të shpallë në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Bashkisë Tiranë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në standat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të

njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Tiranë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- a-Njohurite mbi Ligjin nr.139/2015 për Vetëqëverisjen Vendore;
- b Njohurite mbi Ligjin nr 152/2013 "Për nëpunësin Civil" (i ndryshuar)
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- d- Njohurite mbi Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"(i ndryshuar)
- e- Njohurite mbi Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" (i ndryshuar)

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Tiranë, do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Bashkisë Tiranë, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta

merrni në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Bashkisë Tiranë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut, duke filluar nga data 17/05/2024

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTESOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VECANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndjaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal Bachelor në Shkenca Inxhinierike/Urbanistikë/Arkitekturë.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
https://rekrutimi.tirana.al/CVTemplate_Jeteshkrimi
 - b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
 - c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen online, në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Bashkisë Tiranë, duke filluar me procedurën e regjistrimit të aplikantit dhe duke ndjekur në vijmësi udhëzimet online
<https://tirana.al/punesimi/vende-pune>

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave online për procedurën e pranimi në shërbimin civil duhet të bëhet brenda datës: 17/05/2024

2.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 27/05/2024, Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Tiranë, do të shpallë në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Bashkisë Tiranë, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë kategorinë e mesme e të ulet, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë kategorinë ekzekutive dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Tiranë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- a-Njohurite mbi Ligjin nr.139/2015 për Vetëqëverisjen Vendore;
- b Njohurite mbi Ligjin nr 152/2013 "Për nëpunësin Civil"(i ndryshuar)
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- d- Njohurite mbi Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"(i ndryshuar)
- e- Njohurite mbi Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" (i ndryshuar)

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, **deri në 60 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën , **deri në 15 pikë**.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Tiranë, do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Bashkisë Tiranë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email). Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen elektronike të Portalit të Vëndeve Vakante të Bashkisë Tiranë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure
